



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1084/2014

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me procesmbajtëse Nazmije Beka, në konfliktin administrativ të paditësit, M. F. nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson M. H., avokat nga P., kundër të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Rrezart Gashi, zyrtar ligjor, për shkak të anulimit të përgjigjes, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarve të palëve, më dt.13.12.2016, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, M. F. nga P.. Anulohet përgjigja e të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, me nr.03/788/14, e datës;24.06.2014 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit, M. H., avokat nga P., në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe kërkojmë që gjykata ta anuloj aktvendimin nr.08-7-392 të nxjerrë nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Podujevës dhe përgjigjen e të paditurës të dt.24.06.2014, pasi që i njëjti pa kurrfarë dokumentacioni ligjor ka bërë bartjen e ngastrës kadastrale nr. P-717-12062-01633-0 sipërfaqe prej 24,13 m<sup>2</sup>, zona kadastrale Podujevë, e cila patundshmëri ka qenë në emër të paditësit M. F., kurse e ka bartë në emër të F. F., kusheri i paditësit. Ne kemi bërë ankesa për rishqyrtimin e çështjes për të njëjtën Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Podujevë, vetëm e ka vërtetuar, ku në këshillë juridike ka lënë që t'i drejtohem AKK, të cilës i'u kemi drejtuar, por e njëjta nuk ka nxjerr kurrfarë vendimi apo aktvendimi vetëm me një njoftim, ku e preferon palën se për këtë çështje t'i drejtohet gjykatës kompetente për këtë çështje gjegjësisht Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ne e kemi marrë përgjigjen që ka bërë agjencioni në padi e që nuk ka të bëjë me realitetin që është zhvilluar kjo procedure gjyqësore administrative deri më tani. Prandaj edhe njëherë kërkoj nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke anuluar përgjigjen e të paditurës AKK të dt. 26.04.2014 si dhe aktvendimin e Komunës së Podujevës të dt.21.01.2014 dhe çështjen ta kthej tek e paditura në rishqyrtim dhe rivendosje.

I autorizuari e të paditurës Rrezart Gashi, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar, se, mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, me të cilën e kemi dhënë arsyetimin për nxjerrjen e përgjigjes në kërkesë me dt.24.06.2014, prandaj i propozojmë gjykatës që pas shqyrtimit të përgjigjes në padi dhe të refuzoj padinë e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetoj përgjigjen në kërkesë të dt.24.06.2014.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.13.12.2016, ka bërë administrimin e provave dhe atë: përgjigja e të paditurës e dt.24.06.2014, certifikata e pronës e lëshuar nga Komuna e Podujevës e dt.27.01.2014 dhe dt.07.03.2014, vendimi i lëshuar nga Komuna e Podujevës me dt.27.01.2014, marrëveshja e lidhur me dt.23.08.1960, në mes S. F. dhe B. F. nga P., njoftimi i lëshuar nga Komuna e Podujevës për paditësin e dt.08.01.2014, kërkesa për rishqyrtim e paditësit drejtuar Komunës së Podujevës e dt.29.01.2014, kërkesa e paditësit drejtuar AKK-së dt.03.06.2014, deklaratat e dhënë nga F. F., R. F. B. F. dhe Xh. F. të dhëna pranë noterit S.D. me dt.05.08.2015, dt.03.08.2015 dhe dt.07.08.2015.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e përgjigjes, të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me përgjigjen e të paditurës, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë të datës;24.06.2014, është njoftuar paditësi se, “AKK-ja ju informon se duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 6.1 të Ligjit nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, AKK-ja është kompetente vetëm për rishqyrtimin e vendimeve të Zyrave Komunale Kadastrale”.

Paditësi e pakënaqur me të njëjtën përgjigje, me dt.04.07.2014, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, duke e kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtës.

Gjykata vëren se në këtë rast, gjatë vendosjes nga organi i paditur, lidhur me ankesën-kërkesën e paditësit të datës;03.06.2014, gjenë se është cenuar ligji në dëm të paditësit, prandaj përgjigja e dt.24.06.2014, e lëshuar nga e paditura, nuk mund të merret si e drejtë dhe e bazuar në ligj, për arsye se për vendosjen lidhur me ankesën e paditësit, e paditura ka qenë i detyruar të merr aktvendim dhe atë duke iu referuar nenit 11 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili përcakton se “organet e Administratës Publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizik dhe juridik”.

Nga kuptimi i drejtë i dispozitës së lartcekur, del se organi i paditur, ka qenë i detyruar që lidhur me ankesën-kërkesën e paditësit të dt.03.06.2014, të vendosë me aktvendim, i cili duke u bazuar në dispozitën e nenit 84 par. 2 të këtij ligji, duhet patjetër të përmbaj përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtë ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtët dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Nga këto arsye, gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në riprocedurë të vendosë sipas vërejtjeve në aktgjykim dhe me aktvendim të vendosë lidhur me ankesën-kërkesën e paditësit të dt.03.06.2014.

Vërejtjet e cekura me lart, janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lart, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr.1084/2014, dt.13.12.2016

Procesmbajtëse  
Nazmije Beka

G j y q t a r  
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.